

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, si dhe gjyqtarët Sadije Selmani dhe Atdhe Berisha si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Birsën Kume sekretare juridike e kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarve I. O. nga Prizreni, V. A. nga Prizreni, dhe N. O. nga fshati M., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 lidhur me 31 të **KPK**, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.5/2013 të datës 16.05.2014, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av. R.K., av. P. P., dhe R. H., më datë 25.01.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

I. O., nga i ati M. dhe e ëma F., e vajzërisë J., data e lindjes ..., i lindur në fshatin L. e H., Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

V. A., nga i ati B. dhe e ëma N., e vajzërisë D., data e lindjes..., i lindur në Prizren, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

N. O., nga i ati S. dhe e ëma V., e vajzërisë B., data e lindjes..., i lindur në fshatin M., Komuna e Suharekës, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të **KPP**-së

LIROHEN NGA AKUZA

Se me datë 18.07.2008, në Prizren, të akuzuarit I. O. në cilësinë e personit zyrtar të prokurimit pranë Kuvendit Komunal në Prizren së bashku me të akuzuarit V. A. dhe N. O. anëtarë të Komisionit për vlerësimin dhe hapjen e ofertave në lidhje me tenderin e titulluar “ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren me numër të prokurimit 622-08-143-521, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar tejkalon kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për tjetrin - **NPT “ N.”** nga Prizreni, ashtu që seriozisht shkelin të drejtat e personave të tjerë pjesëmarrës në tender - operatorëve ekonomik “T.”, “H.P.”, “A.” dhe “E.-C.” në atë mënyrë që përcaktohen se operatori ekonomik **N.P.T. “N.”** është fitues i tenderit e titulluar “ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren me një çmim të ofruar prej 76.624,00 euro me 16% zbritje me çmim përfundimtar 64.364,16 euro, duke shënuar informacion të rremë dhe me nënshkrimet e tyre e vërtetojnë përmbajtjen e procesverbalit ekonomik fitues të **N.P.T. “N.”**, përkundër faktik se nuk janë grumbulluar

tre oferta të operatorëve ekonomik të përgjegjshëm sikundër parasheh ligji me prokurimin nr. 2003/17, veprohet në kundërshtim me nenin 57.3 duke konsideruar të përgjegjshëm një tender i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit poashtu shkelet edhe neni 30A4 ku parashihen tre operatorë të përgjegjshëm për të pasur sukses tenderi, e që në rastin konkret operatori ekonomik N.P.T. “N.” dhe N.P.T. “B.” nga Malisheva nuk e kanë përmbushur kushtet që të jenë operator të përgjegjshëm në bazë të mendimit të ekspertit ekonomik financiar, kështu që të akuzuarit përkundër këtyre mangësive si komision kanë marrë pjesë në hapjen e ofertave dhe në vlerësimin e ofertave, dhe kanë rekomanduar lidhjen e kontratës me N.P.T. “N.” nga Prizreni duke shkelur dispozitat e ligjit të prokurimit në fuqi.

- me këto veprime kishin për të kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 lidhur me 31 të KPK.

- pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen.

Shpenzimet e procedurës penale bijën në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.244/2014 të datës 01.12.2014, kundër të akuzuarve, I. O., V. A. që të dy nga Prizreni, dhe N. O. nga fshati M., Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 lidhur me 31 të KPK. Prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor ka ngelur në tërësi pranë aktakuzës, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se nga provat e administruara nga mendimi dhe dëgjimi i ekspertit financiar, para trupit gjykues A. K. si dhe administrimit të provave të propozuara në aktakuzë e në veçanti nga shtjellimi i dokumentacionit të dosjes së tenderimit nderimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren, pa mëdysheje në këto prova është vërtetuar në tërësi përshkrimi faktik i dipozitivit të aktakuzës se këtu i akuzuari i parë si zyrtar i prokurimit pranë Kuvendit Komunal në Prizren I. O. dhe dy anëtarëve tjerë V. A. dhe N. O. me datë 18.07.2008 në Prizren duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtarë nuk i përmbushin detyrat e tyre zyrtare me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për N.T.P. “N.” nga Prizreni ashtu që përcaktohen në mënyrë unanime se operatori ekonomik “N.” është fitues i tenderit të përshkruar si më lart me çmim prej 76.624,00 euro me 16% zbritje, gjegjësisht me një çmim përfundimtarë prej 64.365,00 euro dhe nënshkrimin e tyre vërtetojnë përmbajtjen e procesverbalit të operatorit fitues “N.”, përkundër faktit siç ka theksuar edhe eksperti financiar nuk janë grumbulluar 3 oferta të operatorëve ekonomik të përgjegjshëm konform ligjit mbi prokurimin publik nr. 2003/17 me që operatori ekonomik “N.” nga Prizreni dhe N.T.P. “B.” nga Malisheva, nuk kanë përmbushur kushtet që të jenë operatorë të përgjegjshëm, në veçanti nuk është përmbushur kriteri i kërkuar në tender ajo e planit dinamik si kriter i veçantë. Andaj, prokurori i shtetit thekson se edhe tenderi është dashur që të anulohet nga ana e zyrtarëve të lartcekur, dhe me këto veprime të akuzuarit kanë shkelur të drejtat e personave tjerrë pjesëmarrës, të operatorëve tjerë ekonomik që kanë konkurruar në atë tender të ndërmarrjes “T.”, “H.P.”, “A.” dhe “E.”, andaj në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale në bashkëkryerje të

keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtarë nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPK, e në veçanti formohen elementet se kemi të bëjmë me personat zyrtar të cilët nuk i kanë përmbushur detyrat tyre zyrtare dhe me qëllim që t'i mundësojnë përfitim të kundërligjshëm pasuror duke e shkelur në rastin konkret të drejtat e operatorëve tjerë, duke i propozuar gjykatës që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t'iu shqiptojë dënimin sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit I. O., av. R. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga shqyrtimet gjyqësore dhe nga administrimi i provave nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij I. O. të ketë kryer veprën penale për të cilën i ngarkohet. Në lidhje me tenderin i cili është objekt i akuzës lidhur me nderimin e dyerve dhe dritareve në shkollën filllore “Mati Logoreci”, e cila mban numrin e tenderit me nr. 622-08-143-521, rrjedh se komisioni zyrtar që ka qenë i autorizuar për vlerësimin e ofertave ka bërë njoftim për kontratë në të përditshmen Kosova Sot me dt. 14.06.2008, të cilat oferta janë hapur me dt. 09.07.2008, ku është vlerësuar se 7 ofertues kanë ofertuar, dhe prej tyre 4 kanë qenë të përgjegjshëm, ndërsa 3 ofertues të papërgjegjshëm, dhe në këtë mënyrë janë zbatuar dipozitat e nenit 30 a pika 4 e ligjit mbi prokurimin publik, dhe në këtë çështje nuk është bërë asnjë shkelje, ashtu siç pretendon prokurori i shtetit. Mbrojtësi i të akuzuarit më tej ka theksuar se në ekspertizën e ekspertit të angazhuar në këtë çështje, i njëjti ka analizuar mirë, por nuk ka qenë preciz dhe konciz, pasi që gjatë eleborimit nuk e ka vërejtur rubrikën e cila ka qenë plani dinamik prej 45 ditësh, kërkesë kjo që ka qenë e paraparë me kushtet për hapjen e tenderave, andaj lëshimet e ekspertit kanë ardhur si pasojë e mos konsultimit të tij me zyrën e prokurimit publik në Komunën e Prizrenit. Planin dinamik i kontestuar nuk pasur asnjë vlerë tjetër përveç që bën me dije autoritetit kontraktues se ky afat kohor do të jetë i obligueshëm për aktivitet të operatorit ekonomik “N.”. Si operator i përgjegjshëm është shpallur operatori ekonomik “N.” i cili ka ofruar çmimin 64.364,16 euro, ndërsa operatorët e tjerë janë refuzuar, pasi që kriter substancial ka qenë ofertuesi më i lirë dhe në këtë rast janë plotësuar kriteret të cilat janë paraparë me nenin 30 a pika 4 të të ligjit për prokurim publik i cili ka qenë në fuqi në vitin 2008. Andaj, konsideron se me asnjë fakt nuk është vërtetuar se i mbrojturi i tij I. O. të ketë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, duke i propozuar gjykatës që në kuptim të nenit 364 par. 1 pika 3 ta lirojë nga akuza, në mungesë të provave.

Mbrojtësi i të akuzuarit V. A., av. P. P. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se për të ekzistuar vepra penale keqpërdorimi i pozitës zyrtare duhet të ekzistojë qëllimi, për përfitimin e dobisë pasurore të tjetrit, dhe nga rezultati i provave dhe rrjedhës së kësaj çështje gjatë procedurës së tenderimit dhe fakteve që janë vërtetuar në shqyrtimin gjyqësor, nuk del se ndonjëri nga të akuzuarit ka pasur këtë qëllim. Sipas dispozitave të ligjit të tenderimit dhe mendimit të ekspertit financiar, rezulton se kushtet të cilat përcaktohen në tender përpilohen nga zyrtarët të cilët e shpallin tenderin dhe këto kushte nuk janë ligjore. Duke pasur parasysh mendimin e ekspertit të dhënë në shqyrtimin kryesor, rezulton se në procedurën e tenderimit komisioni tenderues me të drejtë i ka vlerësuar si operator të përgjegjshëm 3 operator, prej të cilëve ka zgjedhur operatorin më të lirë, i cili ka qenë edhe kusht kryesor në këtë tender, andaj edhe sipas mendimit të ekspertit plani dinamik i shënuar në aplikacionin e dokumentacionit për pjesëmarrjen në tender të ndërmarrjes “N.” është i rregullt, pasi që i njëjti ka konstatuar “kjo që është shënuar këtu është esenca që kërkohet, pra numri i ditëve për kryerjen e punës” faqe 4 e procesverbalit. Mbrojtësi, me tej ka deklaruar se eksperti financiar ka theksuar se në rastin e përpilimit të ekspertizës me shkrim nuk ka poseduar dokumentacion nga zyra tenderuese, por i njëjti ka shfrytëzuar vetëm dokumentacionin e tenderit që ka qenë në zyrën e prokurorit dhe mendimin e ka

shprehur nga dokumentacioni që i është prezentuar. Andaj, nga kjo rezulton se mendimi i dhënë në shqyrtimin kryesor është në bazë të dokumentacionit të prezentuar, ndërsa mendimi i ekspertit i dhënë shqyrtim nga ana e trupit gjykues duhet të merret parasysh me rastin e marrjes së vendimit. Prandaj, i ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij V. A. dhe të tjerët duhet të lirohen nga akuza për veprën e cila iu vihet në barrë, pasi që kanë vepruar plotësisht në pajtim me ligjin dhe procedurat tenderuese.

Mbrojtësi i të akuzuarit N. O., av. R. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar, gjatë tërë shqyrtimit gjyqësor në mënyrë të qartë se të akuzuarit nuk kanë pasur dashje që dikush të përfitojë me dhënien e tenderit, dashja në këtë veprë penale është element qenësor. Në vazhdim ka theksuar se në shqyrtimin gjyqësor eksperti A. K. ka deklaruar në mënyrë të saktë se në këtë rast nuk ka shkelje ligjore për dhënien e tenderit fituesit “N.”, prej 7 firmave konkurruese 4 kanë qenë të përgjegjshëm, të shpallur nga komisioni vlerësues, ndërsa eksperti mendon se vetëm dy prej tyre kanë qenë të përgjegjshëm edhe pse secilit prej tyre i ka munguar nga një dokument, dhe në këtë rast nuk ka pasur shkelje ligjore nga ana e komisionit vlerësues, por tenderi është dashur të anulohet për shkak se në tender duhet të jenë 3 ofertues të përgjithshëm, ka propozuar gjykatës që i mbrojturi i tij N. O. të lirohet nga akuza.

Gjatë shqyrtimit kryesorë gjykata ka administruar provat e propozuara dhe atë: 1) mendimin e ekspertit ekonomik financiar A. K. të dt. 06.05.2014, si dëgjimin e tij në shqyrtimin gjyqësor; 2) aktvendimi mbi caktimin e ekspertit financiar HP.nr.5/13 të dt. 28.04.2014; 3) dosja e tenderit “Ndërimi i dyerve dhe dritareve” në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren me nr. 622-143-521 të dt. 13.06.2008; 4) formulari aneks 1 njoftim i kontratës; 5) aneks 2, kërkesat e përshtatshmërisë deklarata nën betim; 6) aneks 3, kërkesat për sigurimin e tenderit; 7) aneks 4, kërkesë për informacione shtesë; 8) draft kontrata dhe kushtet e veçanta dhe anekset e ndërlidhura nr. 622-08-143-521; 9) pjesa e II-të kontratës dhe pjesa e III të kontratës; 10) formulari i pjesës së kontratës së VI të mostrës e garancisë së realizimit dhe formulari i tenderit të punëve; 11) specifikacioni i përmasave dhe para llogarive i objektit ndrimi i dyerve dhe dritareve shk. Fillore “Mati Logoreci” në Prizren - Drejtoria e Arsimit dhe shkencës Kuvendi i Komunës; 12) certifikata e regjistrimit të NPT “N.” me nr. të regj. të biznesit... të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; 13) licenca e kualifikimit nr. 0748 të dt. 28.12.2009 për N.P.T. “N.”; 14) vërtetimi mbi pagesën e obligimeve tatimore të dt. 07.07.2008 për N.P.T. “N.”; 15) certifikata e regjistrimit për TVSH dt. 12.07.2007 N.P.T. “N.”; 16) vërtetimi i Drejtorisë së financave të ekonomisë dhe zhvillimit nr. 4/1-437607 të dt. 07.07.2008 N.P.T. “N.”; 17) referenca e lëshuar nga Komuna e Prizrenit me nr. 444/07 dt. 27.11.2007 N.P.T.“N.”; 18) njoftimi për kontratë të Komunës së Prizrenit i dt. 09.07.2008; 19) përmasa dhe paramasa dhe paralogaria - objekti ndërimi i dyerve dhe dritareve në shkollën “Mati Logoreci” në Prizren me çmime prej numrit rendor nr. 1 të punimeve deri në nën nr. rendor 36 gjithsejtë 76.624,00 euro me zbritje 16% 64.364,16 euro; 20) certifikata e regjistrimit të ndërmarrjes N.P.T. “B.” me seli në Malishevë e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me nr. të biznesit... së bashku me dokumentacionin përcjellës për konkurrim në tender; 21) procesverbali të hapjes së tenderit me nr. 622-08-143 të dt. 09.07.2008 të nënshkruar nga tre të akuzuarit; 22) procesverbali i kontrollimit i vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve “ndrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën Mati Logoreci” në Prizren nr. 622-08-143 të dt. 18.07.2008; 23)

kontrata - e pune KK Prizren sektori i prokurimit dhe OE N.T.P. "N." nga Prizreni të dt. 29.07.2008.

Në ekspertizën e ekspertit ekonomik financiar A. K. të dt. 06.05.2014, i cili në bazë të dokumentacionit të lëndës HP.nr.5/2013 nga Prokuroria Themelore në Prizren, ka bërë analizimin financiar të dokumentacionit të tenderit të titulluar "Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci" në Prizren, me nr. të projektit 622-08-143-521 konstatohet se në pajtim me ligjin e prokurimit publik 2003/17, zyra e prokurimit ka filluar procedurat për kryerjen e punimeve të tenderit të lartcekur, ku kriteri për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët i ofertës së përgjegjshme. Në këtë tender kanë ofertuar 7 (shtatë) ofertues, komisioni ka bërë shqyrtimet dhe vlerësimet lidhur me përputhshmërinë administrativë të tenderit. Komisioni ka vlerësuar katër operator ekonomik si të përgjegjshëm. Vërejtja konkluduese e komisionit ka qenë që kontrata ti jepet operatorit ekonomik N.T.P. "N." nga Prizreni me çmim të ofertuar prej 64.364,00 euro si çmim më i lirë. Sipas mendimit të ekspertit autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 57.3 të ligjit për prokurim publik nr. 2003/17, duke e konsideruar si të përgjegjshëm një tender i cili nuk i ka plotësuar kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit, sipas të cilit operatorit ekonomik N.P.T. "N." nga Prizreni, në dosjen e dorëzuar në tender i ka munguar plani dinamik, i cili ka qenë kërkesë nën numrin rendor 9 në listën e dokumenteve të kërkuara. Gjithashtu, operatori ekonomik N.P.T. "B." nga Malisheva, ka pasur mungesë në dokumentacionin e kërkuar, pasi që i ka munguar dokumentacioni i kërkuar me nr. 12 - në listën e dokumenteve, përkatësisht kontrata për projektet e realizuara në tri vitet e fundit. Andaj, në këtë rast autoriteti kontraktues ka dhënë kontratë në rastin kur vetëm dy operator ekonomik kanë qenë të përgjegjshëm, e në kundërshtim me nenin 30A.4, dhe me dhënien e kësaj kontrate autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të drejtave të operatorëve tjerë ekonomik. Mirëpo, eksperti ka theksuar se lidhur me këtë rast nuk mund të thuhet se ka pasur ndonjë dëm material ndërsa.

Gjatë elaborimit gojorë të ekspertizës eksperti financiar A. K. në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se për tenderin në fjalë kanë konkuruar 7 operator ekonomik, prej të cilëve nga komisioni vlerësues të autoritetit kontraktues 4 prej tyre janë vlerësuar si të përgjegjshëm ndërsa dy prej tyre kanë pasur mangësi në dokumentacionin e dorëzuar gjegjësisht operatori NTP "N." nuk e ka pasur planin dinamik si shkresë e veçantë e që ka qenë kërkesë në numrin rendor 9 në listën e dokumentacionit të kërkuar, ndërsa operatori tjetër ekonomik NPT "B." nga Malisheva i ka munguar dokumentacionin nën numrin rendor 12 që ka qenë kontrata për projekte të realizuara 3 vitet e fundit e për këto arsye në bazë të nenit 57.3 të Ligjit të Prokurimit Publik nr.2003/17 ky tender ka qenë dasht të anulohet përkatësisht të bëhet ritenederimi. Në vazhdim ka deklaruar se në rastin konkret me këtë tender nuk ka pasur dëm material kur i është dhënë tenderi operatorit ekonomik "NTP "N." pasi që është shpallur si fitues i tenderit ofertuesi më i lirë, ndërsa me mos shpalljen e ritenderimit janë cenuar të drejtat e operatorëve të tjerë të cilët kishin mundur të konkurronin, ndërsa operatorëve ekonomik ekzistues që kanë konkuruar në këtë tender nuk u janë shkelur të drejtat sepse fituesi i shpallur ka qenë me çmim më të ulët, pra operatorëve ekzistues ofertues nuk mund të thuhet se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ndërsa lidhur me planin dinamik eksperti ka sqaruar se ky plan paraqet një pasqyrë

kohore të afatit të kryerjes së punëve të punëkryerësit për tenderin e ofruar e që bazuar nga shkresat përkatësisht në dokumentet e ofruara nga operatori ekonomik NTP “N.” afati i kryerjes së punimeve është shënuar (45 ditë) në dokumentin “përmasat dhe parallogaria” por nga kërkesat e dokumentacionit të tenderit është kërkuar si pikë e veçantë të jetë plani dinamik, ekspertit ka sqaruar se në këtë dokument pra në formularin “përmasat dhe parallogaria” ku është shënuar afati i kryerjes së punimeve (45 ditë) është esenca që kërkohet edhe me plan dinamik pra numri i ditëve për kryerjen e punës, mirëpo është dashur të shkruhet në një shkresë të veçantë ku shënohet titulli si plan dinamik dhe me pak fjalë të përshkruhet koha e kryerjes së punimeve

Gjykata duke analizuar ekspertizën e ekspertit financiar si dhe deklarinimin e ekspertit gjatë shqyrtimit kryesor lidhur me ekspertizën e kryer konstatoi se bazuar në këtë ekspertizë procedura e tenderimit në rastin konkret është zhvilluar në pajtim me ligjin në fuqi sa i përket shpalljes së tenderit, kriteri për dhënien e kontratës ka qenë çmimi më i ulët, në rastin konkret janë përzgjedhur 4 ofertuesit të përgjegjshëm dy prej të cilëve sipas ekspertit të papërgjegjshëm, njërit i ka munguar plani dinamik si dokument i veçantë e i cili plan dinamik është shkresë ku shënohen periudhat kohore brenda së cilës operatori ekonomik duhet ti kryej punët sipas tenderit, e që operatori ekonomik “N.” periudhën kohore për kryerjen e punimeve e ka shënuar përkatësisht inkorporuar në një dokument tjetër të tenderit në formularin “përmasat dhe parallogaria” ku ka shënuar periudhën kohore prej (45 ditësh) për kryerjen e punimeve e që sipas ekspertit kjo është esenca e dokumentit planit dinamik përveç se është dashur të paraqitet si shkresë e veçantë, ku shënohet titulli si plan dinamik dhe me pak fjalë përshkruhet koha e kryerjes së punimeve. Operatorit ekonomik NTP “B.” nga Malisheva i ka munguar dokumentacioni nën numrin rendor 12 që ka qenë kontrata për projektet e realizuara tri vitet e fundit. Lidhur me këtë tender sipas ekspertizës por edhe deklarinimit të ekspertit gjykata ka vërtetuar se nuk ka pasur dëm material të shkaktuar nga se kontrata i është dhënë ofertuesit më të lirë në këtë rast operatorit ekonomik “N.” e gjithashtu nuk ka pasur shkelje të drejtave të operatorëve ekonomik të cilët kanë marr pjesë në këtë tender pasi që tenderi i është dhënë operatorit ekonomik me çmim më të ulët, por ka pasur shkelje të të drejtave të operatorëve eventual ekonomik të cilit kishin mundur të konkurronin në raste tenderimit.

- Nga aktvendimi mbi caktimin e ekspertit financiar HP.nr.5/13 të dt. 28.04.2014, gjykata ka vërtetuar se Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka caktuar ekspertin ekonomik financiar A. K. të kryejë ekspertizën dhe analizën financiare të dokumentacionit të tenderit me nr. të projektit 622-08-143-521 i shpallur nga Komuna e Prizrenit me dt. 18.07.2008 me tender të titulluar “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci në Prizren”.

- Nga dosja e tenderit “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve” në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren me nr. 622-143-521 të dt. 13.06.2008, gjykata ka vërtetuar se përgatitja e tenderit të lartcekur ka filluar me datë 13.06.2008, e cila dosje është përbërë prej tri pjesëve ku përfshihen në pjesën A) informacionet për tenderuesit pra identifikimin e autoritetit kontraktues - sektori i prokurimit në KK Prizren, në pjesën B) lënda e kontratës - ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shk. fillore “Mati Logoreci” në Prizren, dhe

në nenin V kriteri për dhënien e kësaj kontrate - vlerësimi i tenderit, operatorit ekonomik duhet të jetë i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët, dhe nën C) është formulari i tenderit, dokumentet të cilat operatori ekonomik prezanton në tenderin konkurrues.

- Nga formulari aneks 1 njoftim i kontratës; aneks 2, kërkesat e përshtatshmërisë deklarata nën betim; aneks 3, kërkesat për sigurimin e tenderit; aneks 4, kërkesë për informacione shtesë; draft kontrata dhe kushtet e veçanta dhe anekset e ndërlidhura nr. 622-08-143-521; pjesa e II-të kontratës dhe pjesa e III të kontratës; formulari i pjesës së kontratës së VI të mostrës e garancisë së realizimit dhe formulari i tenderit të punëve; specifikacioni i përmasave dhe para llogarive i objektit ndrimi i dyerve dhe dritareve shk. Fillore “Mati Logoreci” në Prizren - Drejtoria e Arsimit dhe shkencës Kuvendi i Komunës, gjykata ka vërtetuar se në bazë të nenit 27 të ligjit për prokurimin publik 2003/17, është i gjithë dokumentacioni i nevojshëm i cili duhet të plotësohet nga ana e operatorit ekonomik lidhur me konkurrimin në tender i titulluar “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren.

- Nga certifikata e regjistrimit të NPT “N.” me nr. të regj. të biznesit... të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë; licenca e kualifikimit nr. 0748 të dt. 28.12.2009 për N.P.T. “N.”; vërtetimi mbi pagesën e obligimeve tatimore të dt. 07.07.2008 për N.P.T. “N.”; certifikata e regjistrimit për TVSH dt. 12.07.2007 N.P.T. “N.”; vërtetimi i Drejtorisë së financave të ekonomisë dhe zhvillimit nr. 4/1-437607 ë dt. 07.07.2008 N.P.T. “N.”; referenca e lëshuar nga Komuna e Prizrenit me nr. 444/07 dt. 27.11.2007 N.P.T.“N.”, gjykata ka vërtetuar se janë dokumentet përcjellëse të operatorit ekonomik N.P.T. “N.” për konkurrimin në tenderin për “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci” në Prizren, me nr. të projektit 622-08-143-521.

- Nga përmasa dhe paramasa dhe paralogaria - objekti ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën “Mati Logoreci” në Prizren me çmime prej numrit rendor nr. 1 të punimeve deri në nën nr. rendor 36 gjithsejtë 76.624,00 euro me zbritje 16% 64.364,16 euro, gjykata ka vërtetuar se operatori ekonomik N.P.T. “N.” në Prizren, lidhur me përshkrimin e punimeve në shkollën e lartcekur ka dhënë çmimin për secilën njësi të punimeve, **si dhe afatin e realizimit të këtyre punimeve prej 45 ditë pune.**

- Nga njoftimi për kontratë të Komunës së Prizrenit i dt. 09.07.2008, gjykata ka vërtetuar se Komuna e Prizrenit - sektori për prokurim si autoritet kontraktues ka bërë njoftim për kontratë pune lidhur me ndërrimin e dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren, ku kriteri për dhënien e kontratës së punës ka qenë çmimi më i ulët i ofertës së përgjithshme.

- Nga certifikata e regjistrimit të ndërmarrjes N.P.T. “B.” me seli në Malishevë e lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë me nr. të biznesit... së bashku me dokumentacionin përcjellës për konkurrim në tender, gjykata ka vërtetuar dokumentet përcjellës të operatorit lidhur me konkurrimin në tenderin për “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci” në Prizren, me nr. të projektit 622-08-143-521.

- Nga procesverbali të hapjes së tenderit me nr. 622-08-143 të dt. 09.07.2008, gjykata ka vërtetuar se lidhur me këtë tender kanë konkurruar 7 operator ekonomik, dhe e njëjta është e nënshkruar nga ana tre anëtarëve të komisionit për hapjen e tenderit, në përbërje prej I. O., V. A. dhe A. K..

- Nga procesverbali i kontrollimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve “ndrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën Mati Logoreci” në Prizren nr. 622-08-143 të dt. 18.07.2008, gjykata ka vërtetuar komisioni në përbërje prej tre të akuzuarve pas shqyrtimit dhe vlerësimit lidhur me përputhshmërinë administrative të tenderit, ka vlerësuar se operatori ekonomik N.T.P “N.” nga Prizreni, shpërblehet me kontrate pune me çmim të ofertuar prej 64.364,16 euro.

- Nga kontrata - e pune KK Prizren sektori i prokurimit dhe OE N.T.P. “N.” nga Prizreni të dt. 29.07.2008, gjykata ka vërtetuar kjo kontratë pune është lidhur ndërmjet KK. Prizren - sektori i prokurimit dhe N.T.P. “N.” nga Prizreni, lidhur me “ndrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën Mati Logoreci” në Prizren nr. 622-08-143, me çmimin e tërësishëm për përmbushjen e kësaj kontrate punë në shumën prej 64.364,16 euro, e cila në pjesën e III-të të kontratës të kushtet e veçanta, përkatësisht nenin 11 të saj është paraparë se periudha e ekzekutimit të punimeve do të jetë 45 ditë pune.

I akuzuari I. O. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar, se qëndron në tërësi në deklaratën e dhënë në prokurorinë e shtetit me datë 12.02.2013, duke shtuar se ai ka qenë anëtarë i komisionit për hapjen e ofertave të tenderit “ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci në Prizren”, dhe bazuar në ligjin për prokurimin publik në hapjen e ofertave duhet të marrin pjesë zyrtarët të prokurimit, e në atë kohë kanë qenë vetëm dy zyrtarë, ai dhe A. K., si dhe merre pjesë edhe një zyrtarë i njësisë së kërkesës e që në rastin konkret është drejtorja e arsimit, të cilën e ka prezantuar V. A., dhe pas hapjes së ofertave nga ana e zyrës së prokurimit, formohet komisioni për vlerësimin e ofertave në të cilën komision detyrimisht duhet të jetë së paku një zyrtarë i certifikuar i prokurimit, pasi që në atë kohë zyrtari A. K. ka qenë në pushim vjetor, i vetmi zyrtarë i prokurimit i certifikuar ka mbetur i akuzuari dhe ka marrë pjesë në komisionin për vlerësim dhe njëherit është edhe nënshkrues i kontratës me operatorin ekonomik fitues të tenderit.

I akuzuari V. A. gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar, se ka marrë pjesë si anëtar i komisionit në tenderin e shpallur për ndërrimin e dyerve dhe dritareve në sh. fillore “Mati Logoreci në Prizren, në vlerësimin e dokumenteve në bazë të pikave që janë kërkuar nga zyra e prokurimit. Nuk i kujtohet saktë se sa operatorë kanë qenë të përgjegjshëm, mirëpo fitues në këtë tender është shpallur operatori ekonomik N.P.T. “N.”, pasi që i njëjti i ka plotësuar kushtet ligjore dhe ka qenë me çmim më të ulët të ofertuar. Më tej thekson se për të qenë i suksesshëm një tender duhet të jenë së paku 3 operator ekonomik të përgjegjshëm, e kjo sipas ligjit për prokurimin, dhe në rast se një operator ekonomik nuk i plotëson kushtet e tenderimit, atëherë ai operator do të jetë i pa përgjegjshëm, dhe eliminohet nga konkurrimi. Ndërsa, si kriter bazë për të fituar tenderin ka qenë çmimi më i ulët, dhe në rastin konkret pasi që operatori ekonomik N.P.T. “N.”, i ka plotësuar të gjitha kushtet tenderimit, pra në këtë rast edhe planin dinamik për shkak se në aplikacion janë dokumentet që janë kërkuar, pra afati i realizimit të punimeve, dhe kjo është vlerësuar si plan dinamik edhe në rastin e hapjes së ofertave dhe është pranuar.

I akuzuari N. O., gjatë shqyrtimit gjyqësor në mbrojtjen e tij ka deklaruar, se tenderin për ndërrimin e dyerve dhe dritareve në shkollën Mati Logoreci në Prizren, e ka hapur zyra e prokurimit në Prizren, ndërsa ai ka qenë anëtarë i komisionin vlerësues në këtë tender, dhe fitues i tenderit është shpallur firma “N.”, pasi që ajo ka ofertuar me çmim më të ulët, e cila ka qenë kriter kryesor i përcaktuara nga zyra e prokurimit. Gjithashtu ka

theksuar, se përveç çmimit më të ulët, i ka plotësuar firma “N.”, ka plotësuar e dhe kriteret e tjerë, si edhe plani dinamik të cilën kjo firmë i ka dhënë për 45 ditë, ndërsa dallim në mes të planit dinamik të kërkuar në rastin konkret dhe planit të detajizuar, është se plani i detajizuar kërkohet në ato raste kur ndërtohen ndërtesat nga fillimi dhe shkon në fazat e ndërtimit e deri në kryerjen punimeve, ndërsa në rastin konkret është dashur të hiqen dritaret dhe të vendosen dritare të tjera, pra ka qenë një pozicion, dhe për arsye nuk ka qenë i nevojshëm plani i detajizuar, i cili planë përfshinë një fletë të posaçme në të cilën do të shkruanin të gjitha etapat e kryerjes së punimeve deri në përfundimin e objektit ose të ofertës, duke theksuar se në rastin konkret punimet nga komisioni mbikëqyrës janë konstatuar se janë kryer me kohë dhe të përcaktuar sipas kontratës nga zyra e prokurimit. Dhe në fund thekson se lidhur me këtë tender nuk ka pasur asnjë ankesë.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarve, konstatoi se bazuar në provat të cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, mbrojtjen të dhënë nga ana e të akuzuarve gjykata iu fali besimin. Të akuzuarit pranojnë se kanë qenë anëtarët të komisionit vlerësues në tenderin e shpallur nga zyra e prokurimit në Prizren lidhur me “ndërrimin e dyerve dhe dritareve në shkollën fillore Mati Logoreci në Prizren”, gjegjësisht i akuzuari I. O. ka qenë edhe anëtarë në hapjen e ofertave në tenderin e lartcekur. Kriteri kryesor për fitimin e tenderit ishte çmimi më i ulët i ofertuar nga ana e operatorëve ekonomik, dhe bazuar në këtë fakt komisioni vlerësues e ka shpallur N.P.T. “N.” nga Prizreni fitues të tenderit, pasi që i njëjti i kishte plotësuar të gjitha pikat e kërkuara në këtë tender, për të qenë një operator i përgjegjshëm, në këtë rast edhe planin dinamik të kryerjes së punimeve për 45 ditë, i cili afat ishte respektuar në tersi dhe lidhur me këtë tender nuk ka pasur asnjë ankesë, të cilat fakte gjykata i vërtetoi edhe nga provat e administruara të cilat janë të bashkangjitura në dosjen e tenderit, përkatësisht nga formulari i përmasa, paramasa dhe përllitari i dhënë nga operatori ekonomik N.P.T. “N.”, ku shihet qartë se afati i realizimi të punimeve do të jetë për 45 ditë, nga kontrata e pune në pjesën e III tek kushtet e veçanta, si dhe nga dëgjimi i ekspertit ekonomik financiar A. K. në shqyrtimin gjyqësor i cili ka theksuar se plani dinamik paraqet një pasqyrë kohore të afatit të kryerjes së punimeve të punëkryerësit, e që afati i dhënë në përmasat dhe parallogaria nga ana e operatorit ekonomik është esenca që kërkohet për kryerjen e punës.

Së këndejmi, pas vlerësimit të provave materiale (provave të lart theksuara), dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në tërësi, dhe të gjitha së bashku, gjykata gjeti se nuk është vërtetuar se të akuzuarit të kenë kryer veprën penale e cila i vihet në barrë për të cilën akuzohen nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penale të Republikës së Kosovës.

Së këndejmi, me interes të veçantë në këtë çështje penale, është të vërtetohet se të akuzuarit si anëtarë të komisionit për vlerësimin e ofertave për tender a kanë pasur për qëllim të sjellin dobi pasurore tjetrit – N.P.T. “N.” nga Prizreni dhe me këtë veprim a kanë shkelur të drejtat e personave të tjerë – operatorëve ekonomik pjesëmarrës në këtë tender, pra a ekziston qëllimi i kryerjes së veprës penale (dashja).

Vepra penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 të KPK-së, përcakton: *“Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkel të drejtat e personit tjetër...”*

Pra, përgjegjësinë penale për këtë vepër penale një i akuzuar e ka nëse si person zyrtar e shfrytëzon detyrën apo autorizimet, me tejkalimin e kufijve të autorizimeve të tij me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër duke i shkaktuar dëm personit ose shkel seriozisht të drejtat e personit tjetër.

Ndërsa neni 22 i KPK-së, përcakton se *“dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi i kërkuar si element i veprës penale mund të nxirret nga rrethana faktike”*, pra qëllimin e kryerjes së veprës penale nxirret nga provat dhe faktet e shtjelluara në një çështje penale.

Nga gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nga dëgjimi i ekspertit por edhe nga mbrojtja e të akuzuarve gjykata konstatoi se në rastin konkret nuk është kontestuese se autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit ka shpallur tenderin me nr. 622-08-143-521 të datës 18.07.2008 të titulluar “Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore “Mati Logoreci” në Prizren. Poashtu nuk është kontestuese se si anëtarë të komisionit kanë qenë tre të akuzuarit dhe në këtë tender kanë ofertuar 7 operator ekonomik nga të cilët komisioni ka konstatuar se 4 janë operatorë të përgjegjshëm ndërsa 3 prej tyre nuk i posedojnë dokumentacionet e kërkuara. Si kriter kryesor për dhënien e tenderit ka qenë çmimi më i ulët i ofruar e që në rastin konkret bazua në dokumentacionet e kërkuara këtë çmim e ka ofruar operatori ekonomik NTP “N.” e cila edhe e ka fituar tenderin. Si kontestuese është paraqitur çështja e dokumentacionit të tenderit respektivisht mungesa e planit dinamik si shkresë - akt i veçantë në dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “N.”. Sa i përket planit dinamik gjykata nga ekspertiza si dhe nga elaborimi gojor i ekspertit ka vërtetuar se plani dinamik paraqet periudhën kohore brenda së cilës duhet të kryhen punimet e tenderit të fituar dhe se është një shkresë e thjeshtë ku shënohet titulli dhe me pak fjalë koha e kryerjes së punimeve. Gjkata ka vërtetuar se operatori ekonomik NTP “N.” si fitues i tenderit kohën e kryerjes së punimeve e ka shënuar në një shkresë tjetër përkatësisht në formularin “përmasa dhe parallogaria” ku ka shënuar koha e kryerjes së punimeve 45 ditë pune e që pasqyron afatin e kryerjes së punëve të punëkryesit për tenderin e ofruar e që kjo në fakt është esenca që kërkohet me planin dinamik edhe sipas konstatimit të ekspertit e që në realitet nuk është në kundërshtim me dispozitën e nenit 57.3 të ligjit për prokurimin publik në Kosovë i cili thotë : autoriteti kontraktues do të konsideroj një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në vazhdim kjo dispozitë thotë pavarësisht nga kjo autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse :

(i) *përmban vetëm gabime ose paqartësi që mund të korrigjohen pa pasur nevojë që të ndryshohet ndonjë material ose aspekti i tenderit në fjalë, ose*

(ii) *përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, me kusht që çfarëdo devijimi i tillë të kualifikohet aq sa është e mundshme dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.* Pra, nga dispozita e lartpërmendur vërtetohet se në rastin konkret operatori ekonomik NTP “N.” nga Prizreni nuk ka mundur të konsiderohet si operator i papërgjegjshëm pasi që plani dinamik (periudha kohore për kryerjen e punimeve) edhe pse jo si dokument i veçantë, ka qenë i përfshirë si pjesë e dokumenteve në dokumentacionin e tenderit të këtij operatori në një dokument tjetër e që këto ndryshime përkatësisht devijime në dokumentacionin e tenderit të këtij operatori ekonomik sipas nenit 57.3 pika (ii) janë vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera të parashikuara në njoftimin e kontratës dhe në

dosjen e tenderit dhe si rrjedhojë e kësaj në tenderin konkret operatori NTP “N.” e bëjnë ofertues të përgjegjshëm për çka në rastin konkret bëhen 3 operatorë të përgjegjshëm e që plotësohet kushti që një tender të jetë i suksesshëm me ç rast edhe nuk janë shkelur dispozitat e nenit 30 A.4 për anulimin e tenderit përkatësisht ritenderim.

Andaj, bazuar nga kjo gjendje e çështjes, në rastin konkret janë përmbushur kushtet e parapara me dispozitat e ligjit të prokurimit nr. 2003/17, për të pasur sukses një tender, prandaj në rrethanat e tilla del se rekomandimi i komisionit vlerësues i përbërë nga tre të akuzuarit për lidhjen e kontratës me NTP “N.” nga Prizreni si operatorë ekonomik i përgjegjshëm, si fitues i tenderit me çmim më të lirë të ofruar nuk paraqet dobi pasurore të përfituar në mënyrë të kundërligjshme, dhe si rrjedhojë e kësaj nuk kemi as shkelje të të drejtave të personave tjerë përkatësisht operatorëve ekonomik “T.”, “H.P.”, “A.” dhe “E.C.” ashtu siç pretendon prokuroria, pra përfundimisht është vërtetuar se në rastin konkret nuk ka përfitim pasuror për tjetrin, nuk ka dëm material të shkaktuar dhe nuk ka shkelje të të drejtave të personit tjetër, pra nuk janë plotësuar asnjë nga elementet qenësore të veprës penale e cila iu vihet në barrë të akuzuarve.

Andaj duke u bazuar në të lart – theksuarat dhe provat të cilat u administruan në këtë çështje gjyqësore, gjykata nuk ka provuar se të akuzuarit I. O., V. A. dhe N. O. të kanë kryer veprën penale që iu vihet në barrë me aktakuzë, prandaj të njëjtit i liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrur në kuptim të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në kuptim të nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

**-Departamenti për Krime të Rënda-
P. nr.129/14 të datës 25.01.2016**

**Procesmbajtësja,
Birsen Kume**

**Kryetari i trupit gjykues
Skender Çoçaj**

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.